



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1006/23 Datë: 26/02/2023

Në mbështetje të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ, Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ, Nr.20/12 qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, (përditësuar me vendimin Ref.932/22), Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 114-të, të mbajtur më datë 13.07.2023, mori:

**V E N D I M**

- I. Akreditohen programet e studimit të Fakultetit të Edukimit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2023 – 30 shtator 2026):
  1. Doktoratë në Shkencat e Edukimit (Program i përbashkët/ Doktoratë e dyfishtë), PhD 180 ECTS (A), me kuotën maksimumi 10 studentë për vit akademik;
  2. Master i Edukimit për STEAM, MA 120 ECTS, A, me kuotën maksimumi 20 studentë për vit akademik;
- II. Numri i studentëve si në paragrafin I, zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Fakulteti i Edukimit i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, që deri më datë 15.11.2023 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit.
- IV. Obligohet Fakulteti i Edukimit i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, të raportoj dhe arsyetoj çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista me ndryshim të bartësve aprovet me vendim nga KSHC.
- V. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë si në pikën I, mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## ARSYETIM

Fakulteti i Edukimit i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për akreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	Doktoratë në Shkencat e Edukimit (Program i përbashkët/ Doktoratë e dyfishtë), PhD 180 A	Blerim Saqipi Eda Vula Majlinda Gjellaj Janez Krek Janez Vogrinc
2.	Master i Edukimit për STEAM, MA 120 ECTS, A,	Fatlume Berisha Florent Bunjaku

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin e Edukimit i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:


- Për programin e studimit; *Doktoratë në Shkencat e Edukimit (Program i përbashkët/Doktoratë e dyfishtë), PhD 180 A* vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Melita Kovacevic, Milan Pol dhe Jadranka Pelikan, është organizuar më 14.03.2023, ku nga fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: 36 Standarde thelbësore dhe tetë (8) nga gjithsejtë 16 standardet Plotësuese të akreditimit të përcaktuara me Standardet për Vlerësimin e Programeve të Doktoratës.
- Për programin e studimit; *Master i Edukimit për STEAM, MA 120 ECTS, A*, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Milkos Hoffman, Milan Pol dhe Damian Michalik, është organizuar më 25.05.2023, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht gjashtë (6) dhe Substancialisht një (1) standarde.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 114-të, të mbajtur më datë 13.07.2023, ka shqyrtuar dokumentacionin e Fakulteti i Edukimit i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala mund të parashtroj ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Fakulteti i Edukimit i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”,
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi  
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë



**Affiliate**  
of **ENQA**.